



GJKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Bekim Salihu, bashkëpunëtoren profesionale Fitore Hasani-Ismaili, në çështjen juridike të paditësit [REDACTED] nga Ferizaj, rr. [REDACTED], nr. [REDACTED] kundër të paditurës Komuna Ferizaj-Drejtoria e Arsimit, të cilën e përfaqëson me autorizim [REDACTED], në çështjen juridike pagesa e pagave përcjellëse dhe jubilarë, në prezencën e paditësit, si dhe të përfaqësuesit të të paditurës, në shqyrtimin e mbajtur me datë 19.07.2018, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APPROVOHET, pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit [REDACTED] nga Ferizaj.

II. DETYROHET, e paditura Komuna Ferizaj-Drejtoria e Arsimit, që paditëses në emër të tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit në lartësi prej 1,413.11 €, dhe një page jubilarë në vlerë prej 150%, të një page bazë, në lartësi prej 706.54 €, e që shuma e përgjithshme i bie **2,119.65 € (dy mijë e njëqind nëntëmdhjetë euro e gjashtëdhjetë e pesë cent)**, të cilën shumë e paditura është obliguar t'ia paguaj paditësit, së bashku me kamatën në lartësi prej 8%, duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë 21.02.2018, e deri në pagesën definitive, si dhe të paguaj shpenzimet e kësaj procedurë në shumë prej **40.00 €**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Paditësi [REDACTED] nga Ferizaj në këtë gjykatë me datë 21.02.2018, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna Ferizaj-Drejtoria e Arsimit, lidhur me pagesën e tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe pagesën e tri pagave jubilarë.

Paditësi ka deklaruar se qëndroj pranë padisë së ushtruar pranë kësaj gjykate duke u mbështetur në kontratën kolektive si dhe njëherit bëjë precizimin e kërkesës ashtu që korigjoj parashtrësën e dt.12.04.2018, ku në vend të shumë prej 427.19 duhet të jetë 472.19 €, e që ky fakt vërtetohet edhe nga lista e pagave e cila gjindet në shkresat e lëndës. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbëtem pranë deklarimeve të mëhershme pasi që pas administrimit të provave u vërtetua qartë se kërkesëpadia është e bazuar në ligjë dhe kontratën

kolektive të lidhur mes SBASHK-ut dhe MASHT-it, andaj i propozoj që të aprovohet në tërësi si e bazuar si dhe i kërkoj shpenzimet për taksë gjyqësore.

I autorizuari i të paditurës në përgjigjeje në padi të datës 01.06.2018 dhe në seancën e datës 19.07.2018, ka deklaruar se mbetet në tërësi si në përgjigjen në padi duke kontestuar kërkesë padinë e paditësit lidhur me shpërblimin e tri pagave jubilarë dhe tri pagave përcjellëse, ngase kontrata kolektive e nënshkruar në mesë SBASHK-ut dhe MASHT-it, kurse punëdhënësi është Drejtoria Komunale e Arsimit, nga kjo rezulton se paditura Komuna Ferizaj gjegjësisht Drejtoria e Arsimit nuk është pjesmarrëse e nënshkrimit të kësaj kontrate kolektive ashtu që nuk ka hy në marrëdhënie detyimore e kontestoj edhe shumën e paraqitur nga paditësi në kërkesëpadi sepse në bazë të listave të pagave për muajin shkurt të vitit 2017 ka realizuar pagë neto në shumë prej 470.46 €, për muajin mars shumë prej 470.46 €, kurse për muajin prill shumë prej 472.19 €, e që shuma totale i bie 1413.11 €, kurse sa i përket të drejtës së tij për shpërblimjubilare në shumë prej 708.28 € e që shuma totale për pagat jubilarë dhe paga përcjellëse bazuar në dispozitat e nenit 35 pika 8 dhe 9 të kontratës kolektive të datës 18.04.2017 është shuma 2121.39 €.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së fakteve të çështjes kontestimore, për aq sa palët ndërgjyqëse përmbushin detyrimin e tyre për t'i parashtruar ato, në kuptim të nenit 7.1 të LPK-së, gjykata ka administruar provat si vijojnë:

Përgjigja në kërkesë e Drejtorisë së Arsimit, nr.694 e datës 21.10.2017, formulari për kërkesë apo ankesë në emër të [REDAKTUAR] e datës 25.01.2018, vërtetimi nga Shkolla Fillore e Mesme e Ulët Gjon Sereqi me nr.protokolli 1447 e datës 12.04.2018, vërtetimi nga Shkolla Fillore e Mesme e Ulët Gjon Sereqi me nr.protokolli 1447 e datës 11.04.2018, vendimi i komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave Komuna e Ferizaj me nr.02-112-12-8639-18 i datës, kontrata e punës për mësimepunës nga Drejtoria e Arsimit e datës 02.03.2015, lista e pagave për muajin shkurt, mars dhe prill të vitit 2017.

Gjykata duke i vlerësuar provat një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, se nuk është kontestuese në mesë palëve se paditësi për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare, ka shkuar në pension, e paditura nuk e ka kontestuar pretendimet në padi nga ana e paditësit se ka përvojën e punës mbi 41 vjet.

Meqë leximin e kontratës së punës e datës 02.03.2015, Gjykata ka konstatuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie punë tek e paditura deri në momentin e pensionimit me datë

20.04.2017. Me leximin e shkresës zyrtare nr.694, të datës 21.10.2017, gjykata ka konstatuar se paditësit ju është refuzuar kërkesa për kompensimin e tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, me leximin e shkresës listave të pagave, gjykata ka konstatuar se paditësi në tre muajt e fundit ka realizuar mesatare e pagës në shumë prej 471.03 €.

Gjykata me rastin e përcaktimit të lartësisë për pagën jubilarë në shumën prej 708.54€, si dhe tri pagave përcjellëse shumën prej 1413.11 €, e ka marrë për bazë kontratën e punës të lidhur në mes paditësit dhe të paditurës të dt.02.03.2015, si dhe listave të pagave, ku vërtetohet se paditësi në muajt fundit para daljes në pension dhe atë në shkurt, mars dhe prill, është vërtetuar se mesatarja e pagave mujore e tij ka qenë 471.03€.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë është bazuar në faktin se me kontratën kolektive të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës-Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësin Bashkimin i Sindikatave të Pavarura të Kosovës e cila është nënshkruar nga ana e dy palëve dhe në neni 49 të kësaj kontrate përcaktohet se kjo kontratë hynë në fuqi me ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese të kontratës.

Në pjesën hyrëse respektivisht në nenin 1 të kontratës kolektive është e përcaktuar qartë se kush përfiton nga kontrata kolektive e që në rastin konkret paditësi e ka shfrytëzuar një të drejtë pasi që i njëjti përfiton nga kjo kontratë për faktin se me rastin e daljes se tij në pension kontrata kolektive ka qenë në fuqi e cila nuk është kontestuar nga ana e të paditurës.

Në nenin 35 par. 8 pika 8.1, 8.2, 8.3, dhe 8.4, të kontratës kolektive për të punësuarit në arsimin fillor dhe të mesëm është përcaktuar që punëtori ka të drejtë në shpërblim jubilar për 10 vite të përvojës në punë te punëdhënësi, i fundit në vlerë prej 50 % të një page bazë, për 20 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë prej 75% të një page bazë, për 30 vite të përvojës së punës te punëdhënësi i fundit në vlerë të një page bazë, dhe për 40 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë prej 150% të një page bazë, punëdhënësi i fundit është ai që e paguan shpërblimin jubilar, te shpërblimi jubilar paguhet në afat prej 1 muaji pas plotësimit të kushteve nga kjo pikë, çka do të thotë se e paditura është dashur që me rastin e daljes në pension paditësit brenda 1 muaji sipas nenit 35 par. 8 pika 8.6 të ia paguajë një paga jubilarë në vlerë prej 150% të një page bazë, pasi që i ka plotësuar këto kushte, pasi ka pasur përvojën e punës mbi 41 vjeçare dhe ka qenë obligim i të paditurës që të bëjë pagesën pa pasur nevojë as për të paraqitur ndonjë kërkesë çoftë gojore apo me shkrim të paditurës.

Kurse neni 35 par. 9 të Kontratës kolektive për të punësuarit në arsim fillor dhe të mesëm në Kosovë, është përcaktuar se punëtori ka të drejtë që me rastin e pensionimit në pagesat përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit, e në rastin

konkret Gjykata ka marr parasysh që tri pagat e fundit të punëmarrësit kanë qenë 471.03 €, në tre muajt e fundit para daljes në pension dhe me rastin e vendosjes meqenëse ka pasur ndryshime në pagat, prandaj i ka marrë për bazë tri pagat e fundit që në rastin konkret rezultojnë se paditësi ka pasur pagën mujore tek e paditura shumë më prej 471.03 €.

Pretendimet e përfaqësuesit të paditurës se paditësi kërkesën për kompensimin e pagave përcjellëse duhet të refuzohet për faktin se e paditura nuk ka pasur fonde të veçanta që ti përmbushë këto detyrime, këto pretendime për Gjykatën janë të pa bazuara për faktin se me nenin 2 par. 1.2 të kësaj kontrate të gjitha DKA, në rastin konkret e paditura është e obliguar që ta zbatojë këtë kontratë kolektive dhe me kohë të planifikojë buxhetin për këto raste, e jo të thirret se nuk ka mjete të destinuar për këto raste, andaj edhe përgjegjësia në rastin konkret është tek e paditura e jo tek paditësi.

Se pretendimi i përfaqësuesit i të paditurës, është i pa bazuar se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me institutin e parashkrimit pasi që kjo është rregulluar me dispozitat ligjore të ligjit të punës nr. Ligji 03/L-212, dhe çështja e parashkrimit është e rregulluar me nenin 87, dhe ky afat nuk mundet me u ndryshu me marrëveshje në mes të palëve, se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me zbatimin e institutit të parashkrimit, është edhe për faktin se në nenin 35 par.8 pika 8.5, thuhet decidivisht se punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpenzimin jubilar, e që në rastin konkret rezultojnë se paditësi ka dal në pension tek e paditura dhe kjo ka për obligim që të i paguajë paditësit një page jubilar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, ka obliguar të paditurën që t'ia kompensoj paditësit në emër të pagesës për taksën gjyqësore për padi në shumë prej 40.00 €.


Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

REPUBLIKA E KOSOVËS  **GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ**
REPUBLIKA KOSOVA
C.nr.132/18 date 19.07.2018

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ / FERIZEVAC

Më 10.07.2018
Dana 10.07.2018


Gjyqtari
Bekim Salihu

 **KËSHILLA JURIDIKE** kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të kopjes së aktgjykimit në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.